

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“OKAZIONE DURRES“ SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 10.01.2022, ne të nënshkruarit:

1. **Afrim Hasa**, i datëlindjes 05.07.1975, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi H50705037U
2. **Gjon Marku**, i datëlindjes 04.03.1979, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi H90304071K

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“OKAZIONE DURRES“ SHPK

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 2: Selia

Lagjja 6, Rruga Aleksandër Goga, Pallati 391, Kati i parë, Durrës.

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Agjensi imobiliare.

- Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shërbim ndërmjetësimi në shitjen e pasurive të paluajtshme si dhe çdo lloj pasurie, shërbim ndërmjetësimi në dhënie dhe marrje me qera të pasurive të paluajtshme, këshillime për menaxhim biznesi, shërbim ndërmjetësimi për shitje biznesi, si dhe çdo shërbim tjetër në lidhje me tregun imobiliar në të gjithë nivelet e shërbimit.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04.08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **10.000 (dhjetëmijë)** Lekë, i ndarë në 2 kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Afrim Hasa, është zotërues e 1 kuote, me 50% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 5.000 lekë.

Gjon Marku, është zotërues e 1 kuote, me 50% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 5.000 lekë

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jenë **Z. Afrim Hasa dhe Z. Gjon Marku**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

(-) Administratorët kanë të drejtë të veprojnë bashkërisht ose veç e veç.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.


Neni 8:Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve të Shoqërisë

Afrim Hasa

Handwritten signature of Afrim Hasa in black ink, consisting of a cursive script that reads 'Afrim Hasa' with a stylized flourish below it.

Gjon Marku

Handwritten signature of Gjon Marku in black ink, consisting of a cursive script that reads 'Gjon Marku' with a large, stylized flourish below it.